



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr.29, datë 16.08.2019

PËR

“SHTYRJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË AUTORIZIMIT INDIVIDUAL  
NË BREZAT 900 MHz DHE 1800 MHz TË SIPËRMARRËSIT ALBTELECOM  
SH.A.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Ilir	Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtare
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtare

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës \_\_.08.2019, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr.937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 "Për dhënien e autorizimit individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz”

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 114, dhe neni 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Neni 67, i Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Pika 2, Kreut IV, të VKM-së nr.496, datë 22/07/2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim” (**VKM nr.496**);
4. Rregullores së Brendshme “Për Funksonimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, (**Rregullore nr.7**).

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues i Projekt VKD;
2. Projekt Vendimi i arsyetuar;
3. Urdhër nr. 313 datë 01/08/2019 i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për një ndryshim në Urdhërin nr. 211 datë 22.05.2019 për ngritjen e komisionit ad hoc të negocimit për rinovimin e Autorizimit Individual të sipërmarrësit Albtelecom sh.a.

si dhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Sipërmarrësi “Albtelecom sh.a.”, është paisur me Licencën nr. Nr.253/03/04, datë 01/03/2004, për ofrimin e shërbimit publik të lëvizshëm, tokësor, Standarti GSM në territorin e RSH. Licensa është dhënë nga Kuvendi i RSH, nëpërmjet Ligjit nr.9127, datë 29.07.2003, “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albtelecom”.
2. Referuar nenit 1, të Ligjit 9127/2003, përcaktohej se shoqërisë “Albtelecom sh.a.” i

jepet licencë për ofrimin e shërbimit publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, sipas standardit GSM, nëpërmjet shoqërisë së re të krijuar, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj. Licenca u lëshua natyrisht bashkë me detyrimin e plotësimeve të kushteve si më poshtë:

- a) sigurimi i shërbimit të bëhet i bazuar në brezat e frekuencave 900 dhe 1800 MHz;
- b) ofrimi i shërbimit të fillojë jo më vonë se 12 muaj nga marrja e licencës;
- c) ofrimi i shërbimit të bëhet nga një shoqëri e re, ku "Albtelecom" sha të zotërojë 100 për qind të aksioneve.

3. Gjithashtu ky Ligj autorizonte Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, që të vijonte me procedurat administrative për lëshimin e licencës shoqërisë së re "Albtelecom sh.a". Sigurisht që në zbatim të dispozitave të këtij ligji, ERT e asaj kohe vijoi me dhënien e Licensës për shoqërinë e krijuar posaçërisht sipas ligjit të kohës "Eagle Mobile sh.a." për një afat vlefshmërie 15 vjet (deri në datën 01/03/2019).

Natyrisht, me miratimin e **Ligjit Nr. 9918/2008**, AKEP ndërmori masat përkatëse administrative për të kryer transpozimin e Licencave sipas regjimit të ri duke pajisur sipërmarrësin me Autorizimin Individual (AI), miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr.937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 "Për dhënien e autorizimit individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz".

4. Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së përdorimit të frekuencave dhënë në përdorim këtij sipërmarrësi bazuar në aktet e sipërcituara dhe në vijim të procedurave të parashikuara nga neni 73 i **Ligjit Nr.9918/2008**, si dhe të **VKM-së nr. 496**, AKEP ka kërkuar nëpërmjet shkresës nr.235/4, datë 29/03/2019 gatishmërinë/shprehjen e interesit të sipërmarrësit "Albtelecom sh.a.", për rinovimin e AI në brezin 900 MHz (2x8 MHz) dhe 1800 MHz (2x9 MHz), interes të cilin operatori në fjalë e ka shprehur nëpërmjet shkresës nr.235/6 datë 05/04/2019.
5. Pas marrjes së shprehjes së interesit, AKEP menjëherë ka filluar procedurën administrative për vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të këtyre frekuencave në përputhje me përcaktimet e Kreut II të **VKM-së nr.496**, duke

miratuar në përfundim VKD me nr.13 datë 26/04/2019, “Për miratimin e raportit përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 të sipërmarrësit Albtelecom sh.a”, të shoqëruar gjithashtu me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e AI. Raporti përmbledhës, së bashku me propozimin për çmimin referencë minimal është përcjellë pranë Ministrit të linjës, me qëllim ndjekjen e mëtejshme të procedurave të negocimit.

6. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhërin nr. 211, datë 22.05.2019 ka ngritur Komisionin *ad-hoc* për rinovimin e Autorizimit Individual të Albtelecom sh.a.
7. Grupi Ad Hoc i negocimit ka zhvilluar disa negociata me “Albtelecom sh.a”, duke filluar nga data 28.05.2019 deri 30.07.2019, takime të konfirmuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 235/25 prot. datë 06.08.2019. Nëpërmjet kësaj shkrese MIE njofton AKEP, se në takimin e fundit negociues të datës 30.7.2019, “Alblelecom sh.a” informoi Komisionin *ad hoc*, se kishte zhvilluar një diskutim të brendshëm me administratoret e nivelit të lartë të shoqërisë, si dhe mbledhjen e Bordit të kompanisë në datë 29.7.2019. Produkti i këtyre konsultimeve të brendshme iu paraqitën me shkrim Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në formën e një propozimi që parashtron rrugën dhe mjetet për rinovimin e Autorizimit Individual për të dy brezat e frekuencave, duke kërkuar mundësimin e pagesës sipas çmimit dysHEME të miratuar me vendim të AKEP, për tu paguar me këste e të shtrirë në një periudhë pesë vjeçare.
8. Nisur nga fakti që të ardhurat e pritshme nga procesi i rinovimit të Autorizimit Individual derdhen në buxhetin e shtetit, nga ana e MIE iu kërkuua mendim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me këtë kërkesë të fundit të kompanisë Alblelecom sh.a. Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 14429/1 prot. i MFE të datës 01.08.2019 drejtuar MIE (paraqitur për dijeni edhe AKEP-it me shkresën nr. 235/23 prot. datë 05.08.2019), është risjellë në vëmendje rëndësia e procesit, por është kërkuar më shumë kohë me qëllim analizimin e kërkesës së Albtelecom sh.a.

9. Sa më sipër, MIE nëpërmjet shkresës nr. 235/25 Prot. datë 06.08.2019 ka njoftuar AKEP që procesi negociues shtyhet deri në marrjen e përgjigjes përfundimtare nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Sa më sipër, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me Urdhërin nr. 313, datë 01.08.2019, ka ndryshuar Urdhërin nr. 211, datë 22.05.2019 dhe ka urdhëruar që Komisioni i Negocimit *ad hoc*, të rifillojë procesin e negocimit brenda 5 (pesë) ditësh nga data e përgjigjes së sipërmarrësit për përfaqësinë në këtë komision. Komisioni përfundon negociatat brenda 10 ditëve nga marrja e qëndrimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi propozimin e Albtelecom sh.a.

## II. VLERËSIMI I KËSHILLIT DREJTUES

10. Nisur nga konteksti ligjor i çështjes objekt shqyrtimi, kompleksitetit që kjo e fundit paraqet, Këshilli Drejtues i AKEP vlerëson se referuar dhe Urdhrit të Ministrit nr.313, datë 01/08/2019, procedura e rinovimit të AI për frekuencat në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz, efektivisht e filluar brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 73 të **Ligjit nr.9918/2008**, si dhe të **VKM-së nr.496**, procedurë e cila nuk ka përfunduar përpara përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit individual që disponon sipërmarrësi “Albtelecom sh.a.”.
11. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, gjykon të nevojshme të qartësojë se në kushtet kur në legjislacionin material dhe atë sekondar është parashikuar/ rregulluar efektivisht momenti procedural i zgjatjes së procedurave të rinovimit përtej afateve ligjore, si dhe duke pasur në vëmendje se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte dëm të pariparueshëm mbi interesin publik, dhe të drejtave/interesave të ligjshme të palëve, në përmbushje të plotë të objektivave rregullatore të parashikuar nga neni 7, i ligjit 9918/2008, të faktit se ekzistojnë parakushtet e përcaktuara në nenin 11, të ligjit 44/2015 për ushtrimin e autoritetit publik në mënyrë diskrecionare, ruan të drejtën për të marrë *suo motu* vendim të ndërmjetëm për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së AI të sipërmarrësit “Albtelecom sh.a.”, deri në disponimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mbi përfundimin e procedurës së negocimit të konkretizuar në Aktin e dakortësisë dhe të njoftimit zyrtar në AKEP mbi përfundimin e procedurave të negocimit.
12. Në vijim, KD vlerëson se neni 67 i ligjit nr.44/2015, “Vendimet e Ndërmjetme”, është i zbatueshëm në të gjitha fazat e një procedure administrative, dhe se marrja

apo jo e një vendimi të tillë është tërësisht në diskrecion të organit publik kompetent. Për më tepër VKM nr.496, datë 22/07/2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrin” në Kreun IV të tij, i njeh tagrin AKEP që të ushtrojë të drejtën e marrjes së Vendimeve të ndërmjetme në kushtet dhe rrethanat e parashikuar në këtë VKM.

13. Nisur nga ky kontekst ligjor, është e rëndësishme të theksohet se një vendimarrje e tillë nga AKEP, është realizuar dhe më parë në rastin e rinovimit të AI të sipërmarrësit “Telekom Albania”, me VKD nr.2494, datë 14.08.2014, “Për miratimin e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual miratuar me Vendimin e KD-së të AKEP me nr.530, datë 26/12/2008 të Operatorit të telefonisë së lëvizshme GSM në RSH –Albanian Mobile Communications”.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të nenit 114, të Ligjit nr.9918/2008, nenit 67 të Ligjit Nr. 44/2015, pikës 2, të Kreut IV të VKM nr. 496 si dhe Rregullores nr.7 “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike” e ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP.

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr.937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 "Për dhënien e autorizimit individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz”, deri në nënshkrimin e Aktit të dakortësisë dhe marrjen e njoftimit zyrtar nga MIE mbi përfundimin e procedurës së negociimit me sipërmarrësin Albtelekom, në përputhje me parashikimet e VKM nr 496, datë 22.7.2014.
2. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve, të njoftoj sipërmarrësin “Albtelecom sh.a.”.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Ilir ZELA**

**Ketrin TOPÇIU**

**Xhoana LILAJ**